
KONTRATE SHITBLERJE

Lidhur ne Tirane, sot, me 27.07.2023 (dy mije e njezet e tre), ndermjet paleve te meposhtme:

SHITESIT:

- Z. Brien Hajdari, shtetas shqiptar, lindur ne Tirane me 06.07.1998, banues ne Tirane, person madhor me zotesi te plote per te vepruar, mbajtes i leternjofimit me numer personal J80706053M.
- Z. Besar Llapashtica, shtetas shqiptar, lindur ne Fier me 27.03.1990, banues ne Tirane, person madhor me zotesi te plote per te vepruar, mbajtes i leternjofimit me numer personal J00327070S.
(*ne vijim referuar si "Shitesit"*)

dhe

BLERESI:

- Shoqeria Seman Sunpower sh.p.k, person juridik i se drejtes shqiptare, regjistruar prane Qendres Kombetare te Biznesit me nr. NUIS K81722018P, me seli ne adresen Rr. Murat Toptani, Eurocol Center, Kati 7, Tirane, përfaqësuar nga Administratori Z. Sadik Llapashtica (*ne vijim referuar si "Bleresi"*)

(*Bashkerisht referuar si "Palet"*)

BAZA LIGJORE:

Kodi Civil, Ligji Nr. 9901, date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" i ndryshuar

DEKLARIME PARAPRAKE

Shoqeria "Sea Solar Energy" sh.p.k, eshte person juridik i se drejtes shqiptare, regjistruar prane Qendres Kombetare te Biznesit me nr. NUIS M12403011N, me seli ne adresen Rr. Viena Nr. 3, Tirane - Shqiperi., *me tej referuar si "Shoqeria"*).


Kjo shoqeri zoterohet nga:

- Z.Brien Hajdari, zoterues i 1(nje) kuote te barabarte me 50% te kapitalit te shoqerise "Sea Solar Energy" SHPK;
- Z.Besar Llapashtica, zoterues i 1(nje) kuote te barabarte me 50% te kapitalit te shoqerise "Sea Solar Energy" SHPK;

Shitesit kërkohet te shesin 100% te kapitalin qe zoterojne ne shoqerine Sea Solar Energy shpk tek Bleresi, ne perputhje me kushtet e kesaj kontrate.

Bleresi eshte i interesuar te bleje 100% te kapitalit te Shoqerise.

Per keto arsye, Palet, me vullnetin e tyre te plote, te lire e te pacenuar, vendosin te lidhin kete Kontrate Shitblerje (*ne vijim referuar si "Kontrata"*), me kushtet si me poshte vijon:



**NENI 1
OBJEKTI**

- 1.1. Objekti i kesaj Kontrate eshte percaktimi i kushteve, modaliteteve dhe pasojave te transaksionit mbi shitjen e 100% (njqind perqind) te kapitalit te shoqerise, nga Shitesit tek Bleresi, sipas cmimit te percaktuar ne te.

**NENI 2
Çmimi dhe menyra e pageses**

- 2.1. Palet kane vendosur qe shitja e 100% te kapitalit te Shoqerise nga Shitesit tek Bleresi te jete me çmimin total prej 10 000 (dhjete mije leke). Cmimi per secilin nga shitesit e shoqërisë do te jete 5000 leke. Ky çmim do te paguhet nga Bleresi me nenshkrimin e kesaj kontrate.
- 2.2. Çmimi do te paguhet nga Bleresi ne favor te Shitesit nepermjet transfertes bankare ne nje nga llogarite bankare te ketij te fundit.

**NENI 3
Kalimi i titullit te pronesise**

- 3.1. Titulli i pronesise se 100% te kapitalit te Shoqerise nga Shitesit tek Bleresi kalon ne momentin qe kryhet pagesa e plote ne llogarine e shitesit.

**NENI 4
Efektet e shitjes**

- 4.1. Palet bien dakord se pas nenshkrimit te kesaj Kontrate dhe kalimit te titullit te pronesise nga Shitesit tek Bleresi, Shoqeria do te kete kete strukture ortakesh:
- o **Shoqeria Seman Sunpower** sh.p.k, zoteruese e 1 (nje) kuote te barabarte me 100% te kapitalit te shoqerise "Sea Solar Energy" SHPK;

**NENI 5
Garancite e Paleve**

- 5.1. **Shitesit garantojne Bleresin se:**
Pjeset e kapitalit qe ata zoterojne ne shoqeri dhe qe jane objekt i shitblerjes sipas kesaj kontrate nuk jane subjekt barresimi, ndalimi shitje, te drejte parablerje, garancie bankare, apo e ndonje mjete tjeter i cili siguron ekzekutimin e detyrimeve;

Ka te drejte, aftesi dhe zotesi te plote per te vendosur shitjen e pjeseve qe ai zoteron ne kapital dhe qe jane objekt i kesaj kontrate dhe per te ekzekutuar kete Kontrate sipas parashikimeve te saj, pa patur nevojën per pelqimin apo miratimin paraprak te ndonje personi tjeter, qofte ky fizik apo juridik;

**NENI 6
Demshperblimi**

- 6.1 Shitesit do t'i shperblejne Bleresit demin e shkaktuar, si dhe do ta perjashtojte ate nga pergjegësia lidhur me çdo pretendim, dem, humbje, apo shpenzim, te ngritur ndaj

Shoqerise apo Bleresit lidhur me veprime te kryera, perpara nenshkrimet te kesaj Kontrate, apo qe rezulton si pasoje e:

- Çdo shkelje te garancive te Shitesit, parashikuar ne nenin 5.1 te kesaj Kontrate;
- Çdo shkelje te detyrimeve te Shitesit sipas kesaj Kontrate;

NENI 7 KONFIDENCIALITETI

Palet bien dakord qe kjo Kontrate dhe çdo negociim parakontraktor do te trajtohet ne perputhje me parimin e konfidencialitetit dhe se nuk do te transmetoje asnje te dhene apo informacion lidhur me marredheniet tregtare, financiare apo ligjore te njera-tjetres, si dhe se nuk do te bejne asnje deklarate lidhur me ekzistencen, objektin apo parashikimet e kesaj Kontrate.

Palet perjashtohen nga detyrimi i ruajtjes se konfidencialitetit ne rast se:

- Pala tjetër ka dhene pelqimin per transmetimin e te dhenave;
- Transmetimi behet ne kuader te permbushjes se nje detyrimi;
- Nevojitet per kryerjen e nje detyre ligjore me interes publik;
- Keto te dhena jane bere publike nga vete pala tjetër dhe ndodhen ne domain-in publik dhe/ose jane te aksesueshme nga persona te trete;
- Keto te dhena jane bere publike ose i jane bere te njohura pales qe transmeton te dhenat nga persona te trete.

NENI 8 KOMUNIKIMI NDERMJET PALEVE

Te gjitha komunikimet ndermjet paleve, si dhe kerkesat qe ato kane ndaj njera tjetres, do te kryhen ne menyre shkresore ne adresat e percaktuara nga palet ne pjesen e gjeneraliteteve te tyre.


Ne rast se personat dhe/ose adresat e mesiperme pesojne ndryshime, Pala qe i peson ato ka detyrimin te njoftoje palen tjetër brenda 24 oresh nga momenti i ndryshimit. Ne rast te kundert, çdo komunikim ne adresen e meparshme do te konsiderohet i vlefshem edhe pse mund te mos jete marre nga ana e Pales qe ka ndryshuar personin e kontaktit dhe/ose adresen.

NENI 9 NDRYSHIMET E KONTRATES

Çdo ndryshim i kesaj Kontrate behet me pelqimin e perbashket te paleve dhe do te jete i vlefshem vetem ne rast se behet me shkrim dhe ne nenshkruhet nga te gjitha palet ne kete Kontrate.

NENI 10 Interpretimi i kontrates

Kushtet e percaktuara ne kete kontrate interpretohen pa u ndalur ne kuptimin letrar te fjaleve, por duke pasur parasysh qellimin e vertete te paleve, qe i ka shtyre per nenshkrimin e ketij akti. Kushtet e kontrates interpretohen njeri nepermjet tjetrit, duke i dhene secilit kuptimin qe del nga teresia e aktit. Ne rast dyshimi, kontrata ose kushtet e saj interpretohen ne kuptimin ne te cilin mund te kene ndonje efekt dhe jo ne ate, sipas te cilit nuk do te kishte ndonje efekt.



Ligji i zbatueshem per interpretimin e kesaj Kontrate do te jete legjislacioni ne fuqi ne Republiken e Shqiperise.

NENI 11
ZGJIDHJA E MOSMARREVESHJEVE

- 11.1 Te gjitha mosmarreveshjet qe mund te lindin ndermjet Paleve lidhur me kete Kontrate, palet duhet te perpiqen t'i zgjidhin me mirekuptim.
- 11.2 Nese nuk arrihet nje marreveshje, Kontrata do te jete objekt shqyrtimi gjyqesor dhe kompetente per zgjidhjen e mosmarreveshjes do te jete Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane.

NENI 12
TE TJERA

Bashkelidhur dhe pjese integrale e kesaj Kontrate jane:

- Kopje e leternjoftimit te paleve nenshkruese;
- Vendimi i Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve te shoqerise Sea Solar Energy sh.p.k date 27.07.2023
- Vendim i Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve te shoqerise Seman Sunpower sh.p.k date 27.07.2023

Kjo kontrate eshte hartuar ne 3 (tre) kopje origjinale ne gjuhen shqipe, nga nje per secilen pale nenshkruese.

Kjo kontrate hyn ne fuqi ne daten e nenshkrimit te saj nga palet.

PALET:

SHITESIT:

Z. Brien Hajdari

Brien Hajdari
BH

Z. Besar Llapashtica

Besar Llapashtica
[Signature]
27/07/2023

BLERESI:

Shoqeria Seman Sunpower sh.p.k
Perfaqesuar nga Administratori
Z. Sadik Llapashtica

Sadik Llapashtica
[Signature]